

UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRRORE

Rt. Xhorxh Bush, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381-38-249-873 • E-mail: [fshmn@uni-pr.edu](mailto:fshmn@uni-pr.edu) • [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRRORE  
PRISHTINE

Pranuar me:	Ni. org.	Numër	Sasia	Vlera
22.09.2023	01	4804	2	-

Ref. nr.

Prishtinë, Dt: 22.09.2023

## RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM

Fakulteti

FSHMN

Lëndët

Shkrim akademik (Ligjëratat dhe ushtrime)

Kandidatët e paraqitur

Edona Jahiu

Besjana Sufaj

Nora Nimani Musa

Komisioni vlerësues

1. Kryetar
2. Anëtar
3. Anëtar

Prof. dr. Arben Haziri, kryetar

Prof. ass. dr. Ardita Berisha, anëtare


Prof. ass. dr. Kadire Binaj, anëtare



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"  
 Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

SHËNIMET PËRMBLEDHËSE TË KANDIDATËVE

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grada shkencore	Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata			Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime			Moshë (datëlindja)	Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet)	Bie ndesh me Nenin 7, paragrafi 10, Rregullorja Nr. 1/95, e datës 24/06/2021 (PO/JO)	Propozohet të angazhohet (PO/JO)
			Thirrja akademike	Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me kriteret e Statutit dhe Rregulloren në fuqi për emërimin e personelit akademik	Përvoja e punës profesionale në mjekësinë terciare (Fakulteti i Mjekësisë)	Nota Ba.	Nota Ma.	Specializimi për lëndët klinike në Fakultetin e Mjekësisë				
1	Edona Jahiu	MA		0		9.95	10	28(16.06.1995)	2	JO		
2	Besjana Sufaj	MA		0		9.56	9.33	28(09.01.1995)	1	JO		
3	Nora Nimani Musa	PhD (?)		2		/	/	42(09.08.1981)	3	JO		



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Xhorxh Bushi, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381-38-249-873 • E-mail: [fshmn@uni-pr.edu](mailto:fshmn@uni-pr.edu) • [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

Ref. nr.

Prishtinë, Dt:

## RAPORT


Në konkursin e shpallur nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” (UP) për angazhim të bashkëpuntorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime (Nr. 1/909, te dt. 1.8.2023) për vitin akademik 2023/2024, për pozitën 15 në FSHMN është kërkuar 1 bashkëpuntor i jashtëm për mbajtjen e ligjëratave dhe ushtrimeve për lëndën Shkrim akademik.

Për pozitën 15 kanë aplikuar 3 kandidatë: 1. MA Edona Jahiu, 2. MA Besjana Sufaj, 3. PhD (e panostrifikuar) Nora Nimani Musa.

**MA Edona Jahiu** ka lindur në Gjilan, më 16.06.1995. Ka përfunduar studimet bachelor dhe master në Degen e Gjuhës Shqipe dhe i ka të regjistruara studimet e doktoratës në drejtimin e gjuhësisë, në Fakultetin e Filologjisë, UP. Studimet bachelor i ka përfunduar me notën mesatare 9.95, ndërsa ato master me notën 10. Ka përvujtë 2 vjeçare në mësimdhënie në nivelin akademik, në pozitën për të cilën po aplikon edhe tani, dhe ka pasur vlerësim pozitiv nga menaxhmenti. Ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore nga fusha e gjuhësisë dhe ka botuar punime në revista të ndryshme të fushës, por këto revista nuk janë të indeksuara në platformat Scopus dhe Web of Science. Që nga viti 2015, kandidajta merret edhe me redaktimin gjuhësor të teksteve në një medium kombëtar. Ky specializim i saj lidhet drejtpërdrejt me gëshje të shkrimit akademik.

**MA Besjana Sufaj** ka lindur në Gjakovë, më 09.01.1995. Ka përfunduar studimet bachelor dhe master në Degen e Gjuhës Shqipe dhe i ka të regjistruara studimet e doktoratës në drejtimin e gjuhësisë, në Fakultetin e Filologjisë, UP. Studimet bachelor i ka përfunduar me notën mesatare 9.56, ndërsa ato master me notën 9.33. Ka përvujtë 1 vjeçare në mësimdhënie në nivelin akademik, në Universitetin e Prizrenit. Aktualisht punon si mësimdhënëse e gjuhës shqipe në një shkollë private në Prishtinë. Nuk ka dëshmi për pjesëmarrje në konferenca shkencore apo për publikime shkencore.





UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Xhorxh Bush, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381-38-249-873 • E-mail: [fshmm@uni-pr.edu](mailto:fshmm@uni-pr.edu) • [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)


Ref. nr.

Prishtinë, Dt:

**PhD Nora Nimani Musa** ka lindur në Pejë, më 09.08.1981. Ka përfunduar studimet bachelor në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze në UP, ndërsa studimet master i ka kryer për gazetari në Institutin për Gazetari dhe Komunikim (për të cilat nuk i ka diplomat e bashkëngjitura). Studimet e doktoratës në fushën e anglishtes i ka përfunduar në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Lubjanës. Kandidatja nuk e ka të nostrifikuar diplomën e doktoratës, po ka sjellë dëshminë e aplikimit nga NARIC për nostrifikim. Sipas dokumentacionit të kërkuar në konkursin e shpallur, nëse kandidatja dorëzon vetëm dëshminë e aplikimit për nostrifikim, vendimi për nostrifikim të diplomës përkatëse të fituar jashtë vendit domosdoshmërisht duhet të dorëzohet më së largu 3 ditë para mbledhjes së Këshillit të Fakultetit në të cilin vendoset për lëndën përkatëse, gjë që ende nuk ka ndodhur. Kandidatja i ka të publikuara dy punime në Scopus, nga fusha e mësimdhënies, me fokus anglishten, dhe ka të botuara disa punime të tjera të cilat nuk janë të indeksuara në Scopus dhe Web od Science. Ka sjellë dëshmi për përvojën e punës 3 vjeçare në UP si lektore e gjuhës angleze.

Në bazë të Rregullores për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm nr. 1/95 datë 24.06.2021, komisioni vlerëson se:

- Kandidatja e parë, MA Edona Jahiu, i plotëson kushtet e parapara nga konkursi. Ajo ka notën më të lartë mesatare në studimet bachelor dhe master, ka përvojë 2 vjeçare në pozitën për të cilën aplikon dhe specializimi i saj përkon në mënyrë specifike me pozitën për të cilën aplikon. Gjithashtu, puna e saj e gjetarishme është vlerësuar pozitivisht nga menaxhmenti i institucionit në të cilin ka punuar.
- Kandidatja e dytë, MA Besjana Surfaj, i plotëson kushtet e parapara nga konkursi, por ka notë më të ulët mesatare se kandidatja 1, ka më pak përvojë në mësimdhënie në nivelin akademik dhe nuk ka të botuara punime shkencore.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Xhorxh Bush, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381-38-249-873 • E-mail: [ishmn@uni-pr.edu](mailto:ishmn@uni-pr.edu) • [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

Ref. nr.




Prishtinë, Dt:

- Kandidatja e tretë, PhD Nora Nimani Musa, për shkak se nuk e ka të nostrifikuuar diplomën e doktoratës, nuk i plotëson kushtet e plotësuar në konkurs. Në anën tjetër, ajo gjithashtu nuk i ka sjellë diplomatat e niveleve paraprake të studimeve, dhe rriedhimisht nuk e kemi as notën mesatare për këto studime. Gjithashtu, specializimi i saj për anglishten nuk përkon me shkrimin akademik, i cili në këtë rast kërkon specializim specifik për shqipen.

Në mbështetje të gjithë kësaj dhe bazuar në rregulloren për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunorëve të jashtëm të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (nr. 1/95, dt. 24.06.2021), i propozojmë Këshillit Shkencor – Mësimor të FSHMN-së që për vitin akademik 2023/2024 të angazhojë për bashkëpunore të jashtme për ligjërata dhe ushtrime për poziten 15, kandidaten: **MA Edona Jahiu**.

Dt. 22.09.2023, Prishtinë

Komisioni:

1. Prof.dr. Arben Haziri , kryetar
2. Prof. ass. dr. Ardita Berisha , anëtar
3. Prof. ass. dr. Kadire Binaj , anëtar